Kodi/ Code: SL-RA-GJ-03	Versioni/ Version: 2	Date efektive/ Effective Date: 05/03/2016	Faqe/ Page: 1 / 1

Nr. RAPORTI / REPORT No. :	**4983/20**
Nr. REGJISTRI / REGISTER No. :	165 / 05
POROSITESI / CLIENT:	SEED CONSULTING Sh.p.k
OBJEKTI / OBJECT:	UNAZA E BERATIT
MOSTRA / SAMPLE:	SILTY CLAY/ ARGJILE LYMORE
THELLESIA/ DEPTH:	TP 2 (1.0 - 2.5 m)
DATA E MARRJES SE KAMPIONIT / SAMPLING DATE:	18.05.2020
DATA E TESTIMIT / TESTING DATE:	28.05.2020
METODA E MERRJES SE MOSTRES/ SAMPLING METHOD:	NGA LABORATORI/ FROM LABORATORY
TESTIMI / TEST:	**PERCAKTIMI I RAPORTIT DENSITET-LAGESHTI (PROVA PROCTOR) / DETERMINATION OF MOISTURE-DENSITY RELATION (PROCTOR)**
METODA E TESTIMIT / TEST METHOD:	**AASHTO T 99-2018**

VENDI KU ËSHTË PEFORMUAR TESTI /LAB. LOCATION: 01/A
KUSHTET AMBJENTALE KU ZHVILLOHET TESTI / ENVIRONMENTAL CONDITIONS:
Temperatura/ Temperature : 20.4ºC
Lagështia / Humidity : 50,4%

REZULTATET E TESTIMIT / TEST RESULTS

Pershkrimi / Description	*Njesia matese / Unit*	*Mostra / Sample 1*	*Mostra / Sample 2*	*Mostra / Sample 3*	*Mostra / Sample 4*	*Mostra / Sample 5*
Pesha e enes / Weight of empty jar	gr	85,4	124,1	85,4	85,4	85,4
Pesha e enes + materiali i lagur / Weight of jar+wet material	gr	412,2	325,4	657,1	742,3	327,6
Pesha e enes + materiali pas tharjes / Weight of jar+dry material	gr	375,0	298,1	570,0	634,5	283,4
Pesha e materialit te lagur / Weight of wet material	gr	326,8	201,3	571,7	656,9	242,2
Pesha e materialit te thate / Weight of dry material	gr	289,6	174,0	484,6	549,1	198
Pesha e ujit / Weight of water	gr	37,2	27,3	87,1	107,8	44,2
Permbajtja e lageshtise / Moisture content	%	**12,85**	**15,69**	**17,97**	**19,63**	**22,32**

Pershkrimi / Description	*Njesia matese / Unit*	*Mostra / Sample 1*	*Mostra / Sample 2*	*Mostra / Sample 3*	*Mostra / Sample 4*	*Mostra / Sample 5*
Permbajtja e lageshtise / Moisure content	%	12,85	15,69	17,97	19,63	22,32
Densiteti i lagur / Wet density	kg/m³	1721	1849	1901	1869	1745
Densiteti i thate / Dry density	kg/m³	**1525**	**1598**	**1611**	**1562**	**1427**



TESTUESI / TESTED BY :

Ing./Eng. Klevis SHETELI

PERGJEGJESI I LABORATORIT / HEAD OF LABORATORY :

Ing. / Eng. Entela KAPLLANI

SARP & LAB sh.p.k.
Nipt: L41526502B
Autostrada Tiranë - Durrës, km 29
Komuna Rrashbull, Durrës

Ky raport i nenshtrohet vetem mostres qe i nenshtrohet testimit./ This report belongs only to the sample under the test.
Eshte rreptesisht e ndaluar kopjimi i ketij dokumenti pa autorizimin e laboratorit!!! / It is forbidden to copy this report or part of it without permission of the lab!!!

Data e leshimit te certifikates/ Issue date: 28.05.2020

SARP & LAB	RAPORT TESTIM/ TEST REPORT		LT 069 12 05 17
Kodi/ Code: SL-RA-GJ-03	Versioni/ Version: 2	Date efektive/ Effective Date: 05/03/2016	Faqe/ Page: 1 / 1

Nr. RAPORTI / REPORT No. :	**4885/20**
Nr. REGJISTRI / REGISTER No. :	165 / 05
POROSITESI / CLIENT:	SEED CONSULTING Sh.p.k
OBJEKTI / OBJECT:	UNAZA E BERATIT
MOSTRA / SAMPLE:	SILTY CLAY/ ARGJILE LYMORE
THELLESIA/ DEPTH:	TP 3 (0.5 - 1.8 m)
DATA E MARRJES SE KAMPIONIT / SAMPLING DATE:	18.05.2020
DATA E TESTIMIT / TESTING DATE:	28.05.2020
METODA E MERRJES SE MOSTRES/ SAMPLING METHOD:	NGA LABORATORI/ FROM LABORATORY
TESTIMI / TEST:	**PERCAKTIMI I RAPORTIT DENSITET-LAGESHTI (PROVA PROCTOR) / DETERMINATION OF MOISTURE-DENSITY RELATION (PROCTOR)**
METODA E TESTIMIT / TEST METHOD:	**AASHTO T 99-2018**

VENDI KU ËSHTË PEFORMUAR TESTI /LAB. LOCATION: 01/A

KUSHTET AMBJENTALE KU ZHVILLOHET TESTI / ENVIRONMENTAL CONDITIONS:

Temperatura/ Temperature : 20.4ºC

Lagështia / Humidity : 50,40%

REZULTATET E TESTIMIT / TEST RESULTS

Pershkrimi / Description	*Njesia matese / Unit*	*Mostra / Sample 1*	*Mostra / Sample 2*	*Mostra / Sample 3*	*Mostra / Sample 4*	*Mostra / Sample 5*
Pesha e enes / Weight of empty jar	gr	141,3	100,2	121,3	312,2	245,1
Pesha e enes + materiali i lagur / Weight of jar+wet material	gr	345,2	2320,2	1546,3	845,5	1421,2
Pesha e enes + materiali pas tharjes / Weight of jar+dry material	gr	323,3	2020,2	1321,3	751,5	1189,3
Pesha e materialit te lagur / Weight of wet material	gr	203,9	2220,0	1425,0	533,3	1176,1
Pesha e materialit te thate / Weight of dry material	gr	182,0	1920,0	1200,0	439,3	944,2
Pesha e ujit / Weight of water	gr	21,9	300,0	225,0	94,0	231,9
Permbajtja e lageshtise / Moisture content	%	**12,03**	**15,63**	**18,75**	**21,40**	**24,56**

Pershkrimi / Description	*Njesia matese / Unit*	*Mostra / Sample 1*	*Mostra / Sample 2*	*Mostra / Sample 3*	*Mostra / Sample 4*	*Mostra / Sample 5*
Permbajtja e lageshtise / Moisure content	%	12,03	15,63	18,75	21,40	24,56
Densiteti i lagur / Wet density	kg/m³	1742	1851	1884	1835	1745
Densiteti i thate / Dry density	kg/m³	**1555**	**1601**	**1587**	**1512**	**1401**



TESTUESI / TESTED BY :

Ing./Eng. Klevis SHETELI

PERGJEGJESI I LABORATORIT / HEAD OF LABORATORY :

Ing. / Eng. Entela KAPLLANI

SARP & LAB sh.p.k.
Nipt: L41526502B
Autostrada Tiranë - Durrës, km 29
Komuna Rrashbull, Durrës

Ky raport i nenshtrohet vetem mostres qe i nenshtrohet testimit./ This report belongs only to the sample under the test.
Eshte rreptesisht e ndaluar kopjimi i ketij dokumenti pa autorizimin e laboratorit!!! / It is forbidden to copy this report or part of it without permission of the lab!!!

Data e leshimit te certifikates/ Issue date: 28.05.2020

SARP & LAB	RAPORT TESTIM/ TEST REPORT		LT 069 12 05 17
Kodi/ Code: SL-RA-GJ-03	Versioni/ Version: 2	Date efektive/ Effective Date: 05/03/2016	Faqe/ Page: 1 / 1

Nr. RAPORTI / REPORT No. :	**4987/20**
Nr. REGJISTRI / REGISTER No. :	165 / 05
POROSITESI / CLIENT:	SEED CONSULTING Sh.p.k
OBJEKTI / OBJECT:	UNAZA E BERATIT
MOSTRA / SAMPLE:	SILTY CLAY/ ARGJILE LYMORE
THELLESIA/ DEPTH:	TP 4 (0.8 - 2.5 m)
DATA E MARRJES SE KAMPIONIT / SAMPLING DATE:	18.05.2020
DATA E TESTIMIT / TESTING DATE:	28.05.2020
METODA E MERRJES SE MOSTRES/ SAMPLING METHOD:	NGA LABORATORI/ FROM LABORATORY
TESTIMI / TEST:	**PERCAKTIMI I RAPORTIT DENSITET-LAGESHTI (PROVA PROCTOR) / DETERMINATION OF MOISTURE-DENSITY RELATION (PROCTOR)**
METODA E TESTIMIT / TEST METHOD:	**AASHTO T 99-2018**

VENDI KU ËSHTË PEFORMUAR TESTI /LAB. LOCATION: 01/A

KUSHTET AMBJENTALE KU ZHVILLOHET TESTI / ENVIRONMENTAL CONDITIONS:

Temperatura/ Temperature : 20.1ºC

Lagështia / Humidity : 51,20%

REZULTATET E TESTIMIT / TEST RESULTS

Pershkrimi / Description	*Njesia matese / Unit*	*Mostra / Sample 1*	*Mostra / Sample 2*	*Mostra / Sample 3*	*Mostra / Sample 4*	*Mostra / Sample 5*
Pesha e enes / Weight of empty jar	gr	141,3	95,1	141,8	102,2	102,2
Pesha e enes + materiali i lagur / Weight of jar+wet material	gr	345,2	574,2	614,5	684,5	710,2
Pesha e enes + materiali pas tharjes / Weight of jar+dry material	gr	328,0	521,0	551,0	594,2	605,2
Pesha e materialit te lagur / Weight of wet material	gr	203,9	479,1	472,7	582,3	608
Pesha e materialit te thate / Weight of dry material	gr	186,7	425,9	409,2	492,0	503
Pesha e ujit / Weight of water	gr	17,2	53,2	63,5	90,3	105
Permbajtja e lageshtise / Moisture content	%	**9,21**	**12,49**	**15,52**	**18,35**	**20,87**

Pershkrimi / Description	*Njesia matese / Unit*	*Mostra / Sample 1*	*Mostra / Sample 2*	*Mostra / Sample 3*	*Mostra / Sample 4*	*Mostra / Sample 5*
Permbajtja e lageshtise / Moisure content	%	9,21	12,49	15,52	18,35	20,87
Densiteti i lagur / Wet density	kg/m³	1671	1778	1890	1894	1830
Densiteti i thate / Dry density	kg/m³	**1530**	**1581**	**1636**	**1600**	**1514**



TESTUESI / TESTED BY :

Ing./Eng. Klevis SHETELI

PERGJEGJESI I LABORATORIT / HEAD OF LABORATORY :

Ing. / Eng. Entela KAPLLANI

SARP & LAB sh.p.k.
Nipt: L41526502B
Autostrada Tiranë - Durrës, km 29
Komuna Rrashbull, Durrës

Ky raport i nenshtrohet vetem mostres qe i nenshtrohet testimit./ This report belongs only to the sample under the test.
Eshte rreptesisht e ndaluar kopjimi i ketij dokumenti pa autorizimin e laboratorit!!! / It is forbidden to copy this report or part of it without permission of the lab!!!

Data e leshimit te certifikates/ Issue date: 28.05.2020

SARP & LAB	RAPORT TESTIM/ TEST REPORT		LT 069 12 05 17
Kodi/ Code: SL-RA-GJ-03	Versioni/ Version: 2	Date efektive/ Effective Date: 05/03/2016	Faqe/ Page: 1 / 1

Nr. RAPORTI / REPORT No. :	**4989/20**
Nr. REGJISTRI / REGISTER No. :	165 / 05
POROSITESI / CLIENT:	SEED CONSULTING Sh.p.k
OBJEKTI / OBJECT:	UNAZA E BERATIT
MOSTRA / SAMPLE:	SILTY CLAY/ ARGJILE LYMORE
THELLESIA/ DEPTH:	TP 5 (0.5 - 2.0 m)
DATA E MARRJES SE KAMPIONIT / SAMPLING DATE:	18.05.2020
DATA E TESTIMIT / TESTING DATE:	28.05.2020
METODA E MERRJES SE MOSTRES/ SAMPLING METHOD:	NGA LABORATORI/ FROM LABORATORY
TESTIMI / TEST:	**PERCAKTIMI I RAPORTIT DENSITET-LAGESHTI (PROVA PROCTOR) / DETERMINATION OF MOISTURE-DENSITY RELATION (PROCTOR)**
METODA E TESTIMIT / TEST METHOD:	**AASHTO T 99-2018**

VENDI KU ËSHTË PEFORMUAR TESTI /LAB. LOCATION: 01/A

KUSHTET AMBJENTALE KU ZHVILLOHET TESTI / ENVIRONMENTAL CONDITIONS:

Temperatura/ Temperature : 20.1ºC

Lagështia / Humidity : 51,20%

REZULTATET E TESTIMIT / TEST RESULTS

Pershkrimi / Description	*Njesia matese / Unit*	*Mostra / Sample 1*	*Mostra / Sample 2*	*Mostra / Sample 3*	*Mostra / Sample 4*	*Mostra / Sample 5*
Pesha e enes / Weight of empty jar	gr	350,0	940,0	249,6	295,0	940,0
Pesha e enes + materiali i lagur / Weight of jar+wet material	gr	1547,0	2470,0	982,0	1975,0	2610,0
Pesha e enes + materiali pas tharjes / Weight of jar+dry material	gr	1414,0	2268,9	867,7	1674,0	2280,0
Pesha e materialit te lagur / Weight of wet material	gr	1197,0	1530,0	732,4	1680,0	1670
Pesha e materialit te thate / Weight of dry material	gr	1064,0	1328,9	618,1	1379,0	1340
Pesha e ujit / Weight of water	gr	133,0	201,1	114,3	301,0	330
Permbajtja e lageshtise / Moisture content	%	**12,50**	**15,13**	**18,49**	**21,83**	**24,63**

Pershkrimi / Description	*Njesia matese / Unit*	*Mostra / Sample 1*	*Mostra / Sample 2*	*Mostra / Sample 3*	*Mostra / Sample 4*	*Mostra / Sample 5*
Permbajtja e lageshtise / Moisure content	%	12,50	15,13	18,49	21,83	24,63
Densiteti i lagur / Wet density	kg/m³	1702	1831	1921	1894	1830
Densiteti i thate / Dry density	kg/m³	**1513**	**1590**	**1621**	**1555**	**1468**



TESTUESI / TESTED BY :

Ing./Eng. Klevis SHETELI

PERGJEGJESI I LABORATORIT / HEAD OF LABORATORY :

Ing. / Eng. Entela KAPLLANI

SARP & LAB sh.p.k.
Nipt: L41526502B
Autostrada Tiranë - Durrës, km 29
Komuna Rrashbull, Durrës

Ky raport i nenshtrohet vetem mostres qe i nenshtrohet testimit./ This report belongs only to the sample under the test.
Eshte rreptesisht e ndaluar kopjimi i ketij dokumenti pa autorizimin e laboratorit!!! / It is forbidden to copy this report or part of it without permission of the lab!!!

Data e leshimit te certifikates/ Issue date: 28.05.2020

HARTA E ZONIMIT SIZMIK TË SHQIPERISË

Nxitimi maksimal në truall të kategorisë A, për periudhë rikthimi 475 vjet Shkalla 1:500,000

Në përputhje me përcaktimet e Aneksit Kombëtar për SSH NA EN 1998-1:2004



Vlerat e parametrave që përfaqësojnë spektrin e reagimit elastik të Tipit 1

Tipi truallit	S	TB(s)	TC(s)	TD(s)
A	1,0	0,15	0,4	2,0
B	1,2	0,15	0,5	2,0
C	1,15	0,20	0,6	2,0
D	1,35	0,20	0,8	2,0
E	1,4	0,15	0,5	2,0

Vlerat e parametrave që përfaqësojnë spektrin e reagimit elastik të Tipit 2

Tipi truallit	S	TB(s)	TC(s)	TD(s)
A	1,0	0,05	0,25	1,2
B	1,35	0,05	0,25	1,2
C	1,5	0,10	0,25	1,2
D	1,8	0,10	0,30	1,2
E	1,6	0,05	0,25	1,2

Përcaktimi i tipit të spektrit që duhet përdorur për projektim:

- Në sipërfaqet e territorit brenda kufizimeve të burimeve sizmike (zona 1-a dhe zona 1-b) duhet të përdoret spektri i Tipit 1;
- Në sipërfaqet e territorit jashtë kufizimeve të burimeve sizmike (zonat 2) duhet të përdoret spektri i Tipit 2;
- Në sipërfaqet e territorit që ndodhen në largesë deri në 2 km nga kufiri i zonave të burimeve sizmike rekomandohet të përdoren të dy tipat e spektrave;
- Në sipërfaqet e territorit brenda kufizimeve të burimeve sizmike (zona 1-a dhe zona 1-b) në truall të kategorisë A dhe në sipërfaqet e territorit jashtë kufizimeve të burimeve sizmike (zonat 2) në truall të kategorisë D këshillohet të përdoren të dy tipat e spektrave;

Shënim: Vlerat projektuese janë ato të dhëna numerikisht dhe vlejnë për të gjithë territorin e njësisë administrative

BH 1 L=6.0 m
TP 1 L=3 m
BH Z L=10 m
TP 2 L=3 m
BH 3 L=6.0 m
TP 3 L=3 m
TP 4 L=3 m
BH 4 L=6.0 m
TP 5 L=3 m

REPUBLIKA E SHQIPERISE · BASHKIA BERAT

PROJEKTI: RIKUALIFIKIMI URBAN I UNAZES SE RE BERAT

RAPORTI HIDROLOGJIK DHE HIDROTEKNIK

FAZA : PROJEKT ZBATIMI

GUSHT 2020

PERGATITUR NGA : SEED CONSULTING

SEEDConsulting
Smart Environment
Engineering Design

PERMBAJTJA

1 HYRJE 5
2 KARAKTERISTIKAT MORFOLOGJIKE TË PELLGUT TË LUMIT OSUM 7
3 KUSHTET KLIMATERIKE 10
3.1 Temperatura e ajrit 11
3.2 Rreshjet 11
4 ANALIZA HIDROLOGJIKE 13
4.1 Sasia maksimale ditore e rreshjeve 13
4.2 Kurbat e Intensitetit-Kohezgjatjes-Frekuences 15
4.3 Rrjedhja ujore vjetore dhe maksimale e lumit Osum 19
5 MBROJTJA NGA PERMBYTJET, ARGJINATURA 21
5.1 Percaktimi i parametrave te plotes ne lumin Osum per analizen e argjinatures 22
5.2 Modelimi hidraulik i kalimit te plotes Berat 25
5.3 Perfundime dhe diskutime 32
6 PERCAKTIMI I PRURJES LLOGARITESE NE VARESI TE PERIUDHES SE RIKTHIMIT PER VEPRAT HIDRAULIKE 33
7 URA MBI LUMIN E ZAGORES 34
7.1 Prurja llogaritese 34
8 SISTEMI I KULLIMIT TË UJRAVE ATMOSFERIKE 38
8.1 Kushtet hidraulike te tombinove 38
8.2 HY-8 Software 40
8.3 Rezultatet 41
8.4 Sistemi i kanaleve 48
8.5 Sistemet e kanalizimit te ujrave te shiut 51
8.6 Sistemet e kanalizimit te ujrave te perdorura 55

Figura 1 – Gjurma e rrugëve 5
Figura 2 – Pellgu ujembledhes i lumit Osum deri ne Berat 8
Figura 3 - Harta e zonave klimatike të Shqiperisë 10
Figura 4 –Ecuria vjetore e temperaturës mesatare shumëvjeçare 11
Figura 5 – Rreshjet mujore 12
Figura 6 - Shperndarja zonale e reshjeve ditore neper Shqiperi 14
Figura 7 - Kurbat IKF 19
Figura 8 - Shpërndarja brendavjetore 20
Figura 9 – Planvendosja e argjinatures ekzistuese 1:25000 21
Figura 10 – Planvendosja e rruges sipas projektit 21
Figura 11 – Niveli i rruges perkundrejt nivelit ekzistues ne pjesen e argjinatures 22
Figura 12 - Shperndarja zonale e reshjeve ditore neper Shqiperi 22
Figura 13 – Hidrograma e plotes me probabilitet p = 1% lumi Osum,Berat 25
Figura 14 – Terreni i gjeneruar ne programin HEC-RAS 26
Figura 15 – Gjeometria dhe strukturat e konsideruara ne model 27
Figura 16 – Argjinatura ne modelin hidraulik (me te zeze vija e terrenit) 27
Figura 17 – Te dhenat perfundimtare per rrjedhje te paqendrueshme 28
Figura 18 – Thellesia e ujit per 8 ore e 15 min nga fillimi i plotes 29
Figura 19 – Thellesia e ujit per 10 ore nga fillimi i plotes 29
Figura 20 – Thellesia maksimale e ujit 30
Figura 21 – Kufiri i permbytjes 30
Figura 22 – Kuota maksimale e ujit 31
Figura 23 – Shpejtesia maksimale 31
Figura 24 – Zona e ndertimit te ures 34
Figura 25 – Hidrografi i plotes lumi Zagores 35
Figura 26 – Basenet kryesore te zones se projektit 36
Figura 27 – Modeli i lumit te Zagores L = 350m 37
Figura 28 – Niveli maksimal ne seksionin e ures 37
Figura 29 – Rrjedhja në tombino me hyrje të lirë 38
Figura 30 – Rrjedhja në tombino me hyrje të mbytur 38
Figura 31 – Hyrja dhe dalja e tombinos janë të mbytura dhe ajo punon nën presion 39
Figura 32 – Dalja është e mbytur ndërsa hyrja e tombinos është e lirë 39
Figura 33 – Hyrja e tombinos është e mbytur kurse dalja e lirë 39
Figura 34 – Tombino pjesërisht e mbushur 40
Figura 35 – Hyrja dhe dalja e tombinos janë të lira 40
Figura 36 – Tombino T02 42
Figura 37 – Tombino T03 42
Figura 38 – Tombino T04 43
Figura 39 – Tombino T05 43
Figura 40 – Tombino T06 44
Figura 41 – Tombino T07 44
Figura 42 – Tombino T08 45
Figura 43 – Tombino T08/1 45
Figura 44 – Tombino T09 46
Figura 45 – Parametrat llogaritës të kanalit 48
Figura 46 – Seksioni tërthor i rrjedhës 52

Tabela 1 - Temperatura mesatare, maksimale absolute dhe minimale absolute. Rrjedhja e mesme 11
Tabela 2 – Shpërndarja vjetore e reshjeve dhe te indekseve te saj 12
Tabela 3 - Reshjet maksimale ditore per stacionin e Beratit 13
Tabela 4 – Llogaritja e shpërndarjes së probabiliteteve dhe periudhës s rikthimit për rreshjet maksimale 24 orëshe për stacionin e Beratit 16
Tabela 5 – Shpërndarja e probabiliteteve 17
Tabela 6 – Periudha e perseritjes së shiut maksimal 24 orësh 17
Tabela 7 – Rreshjet per kohzgjatje te ndryshme dhe siguri te ndryshme 18
Tabela 8 – Intensiteti-Kohezgjatja-frekuenca 18
Tabela 9 –Te dhenat kryesore te stacioneve hidrometrike 19
Tabela 10 – Shpërndarja brendavjetore 20
Tabela 11 – Prurjet maksimale sipas vendmatjeve Corovode dhe Ura Vajgurore 20
Tabela 12 – DWA-Udhezues 507-1 per argjinaturat dhe DIN 19712:2013,Tabla 2 23
Tabela 13 – Kriteret e përzgjedhjes së prurjeve llogaritëse 33
Tabela 14 – Prurja maksimale lumi i Zagores 34
Tabela 15 – Lista e tombinove Unaza Berat 47
Tabela 16 – Lista e kanaleve Unaza Berat 50
Tabela 17 – Tabela e llogaritjes se kolektorit 0+244 - 0+780, Unaza Berat 52
Tabela 18 – Tabela e llogaritjes se kolektorit 0+005 - 0+075, Unaza Berat 53
Tabela 19 – Tabela e llogaritjes se kolektorit 0+991 - 1+060, Unaza Berat 54
Tabela 20 – Tabela e llogaritjes se kolektorit 0+120 - 0+322, Rruga sekondare 55
Tabela 21 – Llogaritja e prurjeve të sistemit të kanalizimit të ujrave të përdorura dhe kontrolli i dimensioneve të sistemit të kanalizimeve (prog 0+241 – 0+600, sistemi majtas rruges) 57
Tabela 22 – Llogaritja e prurjeve të sistemit të kanalizimit të ujrave të përdorura dhe kontrolli i dimensioneve të sistemit të kanalizimeve (prog 0+150 – 0+241, sistemi majtas rruges) 58
Tabela 23 – Llogaritja e prurjeve të sistemit të kanalizimit të ujrave të përdorura dhe kontrolli i dimensioneve të sistemit të kanalizimeve (prog 0+000 – 0+100, sistemi majtas rruges) 58
Tabela 24 – Llogaritja e prurjeve të sistemit të kanalizimit të ujrave të përdorura dhe kontrolli i dimensioneve të sistemit të kanalizimeve (prog 0+250 – 0+550, sistemi djathtas rruges) 59
Tabela 25 – Llogaritja e prurjeve të sistemit të kanalizimit të ujrave të përdorura dhe kontrolli i dimensioneve të sistemit të kanalizimeve (prog 0+200 – 0+250, sistemi djathtas rruges) 60
Tabela 26 – Llogaritja e prurjeve të sistemit të kanalizimit të ujrave të përdorura dhe kontrolli i dimensioneve të sistemit të kanalizimeve (prog 0+000 – 0+100, sistemi djathtas rruges) 60

1 HYRJE

Ky Studim konsiston ne analizen hidrologjike të projektit: RIKUALIFIKIMI URBAN I UNAZES SE RE BERAT. Qellimi i ketij Projekt Zbatimi eshte rikualifikimi urban i Unazes se re Berat, permiresimi i infrasktruktures rrugore si dhe lehtesimin e trafikut ne zonen e mbrojtur nga UNESCO. Lehtesimi i trafikur do te vije se pasoje e devijimit te trafikut te renduar ne unazen perimetrale te qytetit duke e spostuar levizjen e mjeteve larg qendres se qytetit.



Figura 1 – Gjurma e rrugëve

Gjurma ku kalon rruga eshte e pasur me trupa ujore siperfaqesore. Nga njera ane e saj ajo nderpritet nga shume kanale, perrenj dhe lumenj te cilat shkarkojne ne lumin Osum. Ndersa vete rruga shtrihet paralel me lumin Osum. Nga figura e mesiperme duket se rruga ndodhet mjaft afer brigjeve te lumit. Ne kete situate mund te themi se ne rastet e prurjeve maksimale rruga mund te sherbeje si argjinature. Per me teper kilometri i pare rruges, e cila eshte rruge ekzistuese, ndodhet ne mbi kuroren e argjinatures e cila ka sherbyer per mbrojtjen e tokave te mbjella nga permbytjet. Pas viteve 1990 ne kete zone jane ndertuar banesa te reja dhe argjinatura eshte perdorur si rruge. Per t'iu pergjigjur shfrytezimit normal te kesaj rruge nga banoret eshte e detyrueshme qe rikonstruksioni i saj ne kilometrin e pare te perfshije uljen e kuotes se aksit. Prandaj funksioni si argjinature ekzistuese humbet ne kete pjese. Per ta zvendesuar kete pjese eshte menduar qe te vendoset nje korsi biçikletash ne anen e jashtme e cila do te jete ne mbushje dhe do te sherbeje si argjinature.

Ne keto kushte detyra e studimit hidrologjik dhe hidroteknik shtrihet ne disa drejtime:

1- Studimi i rruges si argjinature dhe mbrojtja qe ajo siguron ne nje pjese te mire te gjatesise se saj

Per kete eshte e nevojshme studimi i prurjeve maksimale te lumit Osum si dhe hidrografi i prurjes llogaritese te argjinatures.

2- Projektimi i veprave hidraulike te rruges si tombino, ura, kanale kulluese, sisteme kulluese ne zonat urbane etj.

Per kete pjese eshte e nevojshme analiza e shirave maksimale me kohezgjatje te ndryshme te cilat do te perdoren per percaktimin e prurjeve llogaritese te ketyre veprave me ane te metodes racionale.

2 KARAKTERISTIKAT MORFOLOGJIKE TË PELLGUT TË LUMIT OSUM

Pellgu ujëmbledhës i lumit Osum ka një sipërfaqe prej 2142 km2. gjatësia e përgjithshme e këtij lumi është 160.7 km. Osumi formohet nga bashkimi I përrenjve te shumte qe rrjedhin nga shpatet jugore te masivit malor te Vithkuqit dhe te shpateve perëndimore te zhveshura te Gramozit. Lumi i vogël I Leshnjes, mbasi del ne territorin me një lartësi prej 1000 m mbi nivelin e detit merr emrin lumi Osum.

Duke filluar nga burimi I tij, lumi Osum ne fillim rrjedh ne drejtimin jug-lindje, me tej ai merr drejtimin për ne veri-perëndim duke përshkuar nga te tre anët malin e Lungut. Në fillim Lumi Osum merre ujërat e përrenjve dhe rrëkeve te shumta qe rrjedhin nga shpatet e zhveshura te Moravës dhe te Gramozit e me vone lumi kalon ne një zone gati me brigje vertikale. Mbas bashkimit te ujërave te përroit te Leshnjes dhe përroit te Kolopakes me sipërfaqe 85.4 km2 e deri sa del ne zonen e Skraparit, Osumi merr ujërat e një sere përrenjve malore si: përroit te Viliges me sipërfaqe 39.8 km2, përroi I Vodices me sipërfaqe 53.6 km2, përroi i Gostivishtit me sipërfaqe prej 47.58 km2, përroit te Kallaveshit me sipërfaqe prej 45.2 km2 si dhe përroin e Staraveckes me sipërfaqe prej 49.5 km2 si dhe te përroit te Molinalit (Kreshovës) me një sipërfaqe prej 73.7 km2.

Ne zonën e Skraparit Osumi në fillim nga e djathta e pellgut merr ujerat e përroit te Çorovodës me një sipërfaqe te pellgut ujëmbledhës prej 133.4 km2. Me tej Osumi vazhdon rrjedhën e tij për ne drejtim veri-perëndim deri sa del ne Fushën e Beratit, duke lënë në të djathte të rrjedhjes vargun malor te Tomorit (2417 m) dhe malin Kulmak (2175 m). Gjatë këtij segmenti lumi i Osumit merr me vete ujërat e disa përrenjve si Borovës me sipërfaqe 56.2 km2, përroit te Vokopolës me sipërfaqe 115.6. km2, ujërat e përroit te Vertopit me sipërfaqe prej 48.8 km2, i ujërat e përroit te Peshtanit me sipërfaqe 24 km2, përroit te Roshnikut me sipërfaqe prej 63.0 km2 dhe ujërat e përroit te Zagorisë me sipërfaqe prej 36.9 km2.

Ne luginën e gjere te Beratit, Osumi mbasi merr ujërat e përroit te Velabishtit me sipërfaqe te pellgut ujëmbledhës prej 184.8 km2 dhe ujërat e përroit te Lapardhasë me sipërfaqe prej 125 km2 bashkohet me lumin Devoll.



Figura 2 – Pellgu ujembledhes i lumit Osum deri ne Berat

Vlera mesatare e lartësisë se pellgut ujëmbledhës te lumit te Osumit është 828 m gjë qe tregon për një karakter te theksuar malor te ndërtimit te sipërfaqes se pellgut. Pjesa dërmuese e territorit te sipërfaqes se këtij pellgu është e përberë prej dy zonash kryesore morfometrike: zona e relievit malor dhe zona e relievit kodrinor.

Zona malore përfaqëson pjesën me perëndimore te tij e cila kufizohet nga faqja perëndimore e vargut malor te Llofkes (1878 m) Gramozit (2523 m) Balës (2178 m), nga ku territor ujëmbledhës, furnizohen me ujë përrenjtë malore si Leshnja me lartësi mesatare te pellgut te tij prej 1344 m, përroi i Kolopakes me lartësi 1352 m, përroi i Viliges me lartësi 1162 m, përroi i Vodices me lartësi 1331 dhe përroi I Gostivishtit me lartësi 1269 m mbi nivelin e detit. Mbasi merr ujërat e përroit te Gostivishtit, lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës te Osumit vazhdon te jete e madhe: 1266 m mbi nivelin e detit. Ne vazhdim te rrjedhës se tij për ne perëndim Osumi mbledh ujërat e përrenjve qe zbresin nga shpatet veriore te vargut malor te Dangëllisë dhe te shpateve jug-perëndimore te malit te Ostrovicës. Nga ky territor ujëmbledhës furnizohet me ujë seria tjetër e përrenjve po me karakter te theksuar malor si përroi I Kallaveshit me lartësi mesatare 1164 m, përroi i Treskës me lartësi mesatare 1333 m dhe përroi i Panaritit me lartësi 1266 m mbi nivelin e detit. Mbasi merr ujërat e përroit te Panaritit lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës te Osumit me një sipërfaqe prej 640 km2, vazhdon te jete gjithmonë e larte prej 1224 m. Në vazhdim të rrjedhës për në drejtim të perëndimit e deri në bashkimin me ujërat e përroit të Çorovodës, Osumi grumbullon ujërat e disa përrenjve malore, lartësia mesatare e sipërfaqes se pellgjeve ujëmbledhëse te se cilëve është rreth 1000 m, si psh, ujërat e përroit te Micanit, te Straveckes dhe te Malindit. Si rezultat lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës te Osumit, para bashkimit me ujërat e përroit te Çorovodës , qe është një nga afluentët me te rëndësishëm te lumit Osum, ushqehet me ujë nga shpatet jug-perëndimore te malit te Ostrovicës (2383 m) dhe te Zaloshnjes (2175 m). meqenëse lartësia e këtyre maleve është e madhe dhe vete lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës te përroit te Çorovodës rezulton e larte, 1200 m mbi nivelin e detit.

Si rezultat edhe pasi merr ujërat e përroit te Çorovodës, sipërfaqja ujëmbledhëse e lumit Osum qe arrin vlerën 1108.89 km2 ose rreth ½ e sipërfaqes se përgjithshme te këtij lumi, e ka lartësinë mesatare te pellgut ujëmbledhës ende te madhe 1112.9 m mbi nivelin e detit.

3 KUSHTET KLIMATERIKE

Pellgu ujëmbledhës i Lumit Osum, (dege kryesore e lumit Seman) me drejtimin kryesor te rrjedhjes nga juglindja ne perëndim, shtrihet ne disa zona klimatike. a. Zona klimatike mesdhetare malore juglindore, b. Mesdhetare paramalore jugore, c. Mesdhetare kodrinore qendrore dhe se fundi vazhdon shtrirjen e tij deri ne bashkimin me Lumin Devoll ne zonën klimatike fushore qendrore.
Në rastin tone zona e Beratit përfshihet në rrjedhjen e mesme.
Rrjedhja e mesme karakterizohet me klime mesdhetare paramalore jugore dhe pjesërisht me atë malore jugore. Si e tille ajo ka pothuaj atë regjim si te rrjedhjes se sipërme por ne nivele me te zbutura, te cilat reflektohet ne elementet klimatik te analizuar me poshtë.
Lugina e lumit Osum edhe këtu ndikon si ne zbutjen e klimës gjate muajve te dimrit ashtu dhe ne freskimin e muajve te verës.



Figura 3 - Harta e zonave klimatike të Shqiperisë

3.1 Temperatura e ajrit

Siç e thamë edhe me sipër shtrirja e madhe dhe pozicioni gjeografik ndikon ne kushtet klimatike te këtij zone. Si rrjedhim temperaturat mesatare ndryshojnë nga 3.7°C ne muajt e ftohte (janar) deri ne 21.3°C ne korrik. Temperatura mesatare vjetore eshte 12.3°C.
Temperaturat maksimale absolute ne serinë shumëvjeçare arrihet ne korrik 42.0°C dhe ajo minimale absolute arrihet ne janar -16.0°C. Tab.1

muajt	**I**	**II**	**III**	**IV**	**V**	**VI**	**VII**	**VIII**	**IX**	**X**	**XI**	**XII**
Temp.mes	**3.7**	**4.4**	**6.9**	**10.4**	**15.0**	**18.5**	**21.3**	**21.3**	**18.3**	**13.7**	**8.7**	**5.1**
Max.abs	**21.6**	**25.8**	**27.8**	**31**	**35.8**	**39.4**	**42**	**39.3**	**35.6**	**31.6**	**25**	**21.5**
Min.abs.	**-16.0**	**-14.3**	**-10.5**	**-3.2**	**-0.5**	**3.5**	**4.5**	**6.5**	**3.5**	**-4**	**-10.2**	**-13.5**

Tabela 1 - Temperatura mesatare, maksimale absolute dhe minimale absolute. Rrjedhja e mesme

Në fig. 4 është paraqitur grafikisht ecuria vjetore e temperaturave mesatare e cila na tregon qarte se vlerat e saj kane një ecuri normale me maksimum ne muajin korrik dhe minimum ne muajin janar.



Figura 4 –Ecuria vjetore e temperaturës mesatare shumëvjeçare

3.2 Rreshjet

Rreth 66% te sasisë vjetore te reshjeve bien ne periudhën e ftohte te vitit dhe rreth 34% e tyre ne muajt e verës. Sasia vjetore e reshjeve është mesatarisht 1139mm.
Tabela 2 jep shpërndarjen e reshjeve gjate vitit, reshjet maksimale absolute sipas muajve si dhe numrin e ditëve me reshje > 1.0 mm.

muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
reshjet	120.1	107.6	99.3	98.4	91.7	58.4	37.4	38.7	63.7	120.6	159.2	143.7
Max.24h	81.3	73.2	74	80.5	62.3	62.3	86.5	51.5	66.4	137.6	91.4	141.2
nr>1.0mm	9.9	10.2	10.3	10.5	9.3	6.4	4.1	4.2	5.9	8.0	10.8	10.7

Tabela 2 – Shpërndarja vjetore e reshjeve dhe te indekseve te saj

Siç shihet vlera maksimale e reshjeve 24 orësh 141.2 mm e regjistruar ne muajin dhjetor, është gati njëlloj me maksimumin 24oresh te reshjeve regjistruar ne rrjedhjen e sipërme. Edhe shuma vjetore e reshjeve tregon se vetëm për rreth 100 mm me tepër është diferenca nga rrjedhja e sipërme.
Ndërkaq numri mesatar i ditëve me reshje >1.0 mm është 99.4 dite.
Ne më poshtë ne te cilin jepen ecuria vjetore e reshjeve mesatare dhe numri i ditëve me reshje >1.0 mm duket qarte ecuria e njëjte e tyre, pra vlerat me te larta regjistrohen ne muajt e ftohte te vitit dhe ato me te ulta ne muajt e verës.



Figura 5 – Rreshjet mujore

Nga keto te dhena, mund te shihet se vlerat maksimale jane verejtur ne muajt e dimrit dhe ato minimale ne muajin Korrik. Vlera mesatare per te gjithe vitin eshte 1050 mm per stacionin e Ballshit.
Rënia e borës është dukuri në periudhën e ftohtë të vitit në muajt Dhjetor-Janar. Numri i ditëve me borë është 5 ditë gjatë vitit. Gjithashtu dhe numri i ditëve me shtresë bore, ndërsa mesatarja e maksimale e trashësisë së borës është 25 cm vjetore.

4 ANALIZA HIDROLOGJIKE

4.1 Sasia maksimale ditore e rreshjeve

Nga investigimi i te dhenave egzistuese hidrometeorologjike dolen keto rezultate:

- Disponohen te dhena per elementet meteorologjike nga stacioni meteorologjik i Beratit.
- Disponohen te dhena te rreshjeve mesatare dhe maksimale nga stacioni meteorologjik i Beratit per periudhen 1946 – 1970.

Investigimi i reshjeve te dendura eshte thelbesor per te percaktuar intensitetin klimatik dhe probabilitetin per stuhite. Eshte e dobishme te nxirret piku i shkarkimit me nje probabilitet te caktuar tejkalimi. Kjo nevojitet per hartimin e projektit te:

- Urave
- Tombinove
- Kanaleve anesore
- Sistemit te drenazhit per trupin e rruges

Basenet brenda rajonit te studimit variojne nga shume te vegjel ne mesatarisht te vegjel. Prandaj ne kete kapitull flitet per reshje te shkurtra dhe shume te shkurtra (dhe me intensitet te larte). Në tabelën e mëposhtme jepen vlerat maksimale vjetore të rreshjeve 24 orëshe për periudhën 1946-1970.

Tabela 3 - Reshjet maksimale ditore per stacionin e Beratit

Viti	Rreshjet max 24 ore (mm)
1946	52
1947	70.5
1948	50.4
1949	41
1950	55
1951	76.2
1952	39.4
1953	45.4
1954	28.9
1955	36.8
1956	40.9
1957	42.6
1958	59.5
1959	74.9
1960	72.8
1961	50.4

1962	82.7
1963	98.2
1964	64.7
1965	57.9
1966	48.7
1967	44.2
1968	55
1969	70.2
1970	67.9

Nje harte e shperndarjes zonale te dendesise se reshjeve gjate 24 oreve me probabilitet 1% jepet ne figuren 6.



Figura 6 - Shperndarja zonale e reshjeve ditore neper Shqiperi

4.2 Kurbat e Intensitetit-Kohezgjatjes-Frekuences

4.2.1 Perfundimi Statistikor

Intensiteti i reshjeve tregohet nepermjet kurbave te intensitetit-kohezgjatjes-frekuences. Nje kurbe intensiteti-kohezgjatje-frekuence (Kurba IKF) eshte nje paraqitje grafike ose matematikore e probabilitetit qe nje reshje me intensitet mesatar te caktuar te ndodhe (zakonisht ne nje vit).

Intensiteti i reshjeve (mm/ore), kohezgjatja e reshjeve (sa ore ra shi me ate intensitet) dhe frekuenca e reshjeve (sa shpesh ajo stuhi shiu u perserit) jane parametrat qe perbejne boshtet e grafikut te kurbes IKF. Kurbat IKF e reshjeve perftohen nga vezhgimi i maksimumeve vjetore te reshjeve per periudha te ndryshme te kohes.
Per llogaritjen e shirave me kohezgjatje dhe siguri te ndryshme eshte perdorur formula e njohur:

$$h_{p,t} = H_{p,24}\left(\frac{t}{24}\right)^n$$

$H_{p,24}$ – lartesia maksimale ditore e shiut me siguri p

t – kohezgjatja e shiut

n – parameter i reduktimit varion nga 0.25 – 0.5 dhe varet nga vendmatja

Për llogaritjen e lartësisë maksimale të rreshjeve 24 orëshe me siguri të ndryshme kemi përdorur funksionin e shpërndarjes së vlerave ekstreme (shpërndarja Gumbel). Ky funksion ka pamjen e mëposhtme:

$$f(x) = e^{-\left(e^{-\left(\frac{(x-u)}{\alpha}\right)}\right)}$$

$$\bar{x} = \sum_{i=1}^{n} \frac{x_i}{n}$$

$$s_x^2 = \frac{1}{n}\sum_{i=1}^{n}(\bar{x} - x_i)^2$$

$$u = \bar{x} - 0.5772\alpha$$

$$\alpha = \frac{\sqrt{6} * s_x}{\pi}$$

Të dhënat e përdorura janë ato të paraqitura në tabelën e mësipërme e cila paraqet rreshjet maksimale absolute nga viti 1946-1970.

Viti	Rreshjet max 24 ore (mm)	Rendi	Probabiliteti i tejkalimit	Probabiliteti i moskalimit	Periudha e rikthimit
1954	28.9	25	0.005448112	0.994551888	1.005477956
1955	36.8	24	0.061483929	0.938516071	1.065511855
1952	39.4	23	0.103294767	0.896705233	1.11519367
1956	40.9	22	0.133188366	0.866811634	1.153653182
1949	41	21	0.135322448	0.864677552	1.156500475
1957	42.6	20	0.171675223	0.828324777	1.207255932
1967	44.2	19	0.211715024	0.788284976	1.268576759
1953	45.4	18	0.243698873	0.756301127	1.32222466
1966	48.7	17	0.33714446	0.66285554	1.508624339
1948	50.4	16	0.386607492	0.613392508	1.630277494
1961	50.4	15	0.386607492	0.613392508	1.630277494
1946	52	14	0.432883692	0.567116308	1.763306725
1950	55	13	0.516701373	0.483298627	2.069114091
1968	55	12	0.516701373	0.483298627	2.069114091
1965	57.9	11	0.591645161	0.408354839	2.448850618
1958	59.5	10	0.629764759	0.370235241	2.700985456
1964	64.7	9	0.736111323	0.263888677	3.789476733
1970	67.9	8	0.788349594	0.211650406	4.724772414
1969	70.2	7	0.820183407	0.179816593	5.561222025
1947	70.5	6	0.824007929	0.175992071	5.68207418
1960	72.8	5	0.85099187	0.14900813	6.711043194
1959	74.9	4	0.872283908	0.127716092	7.829866905
1951	76.2	3	0.884017946	0.115982054	8.622023561
1962	82.7	2	0.928958255	0.071041745	14.0762309
1963	98.2	1	0.978627802	0.021372198	46.78975982
	107.9		0.990025893	0.009974107	100.2596064
	128.24		0.997998614	0.002001386	499.6536579

Tabela 4 – Llogaritja e shpërndarjes së probabiliteteve dhe periudhës s rikthimit për rreshjet maksimale 24 orëshe për stacionin e Beratit



Tabela 5 – Shpërndarja e probabiliteteve



Tabela 6 – Periudha e perseritjes së shiut maksimal 24 orësh

	Lartesia(mm)			
	Periudha e rikthimit (vite)			
Kohezgjatja (ore)	**500**	**100**	**50**	**20**
24	128.5	108.0	100	90.45
12	99.1	83.3	77.1	69.746
6	76.4	64.2	59.5	53.782
2	50.6	42.5	39.4	35.622
1	39.0	32.8	30.4	27.468
0.5	30.1	25.3	23.4	21.181
0.33	25.8	21.6	20.0	18.125
0.25	23.2	19.5	18.1	16.333
0.1667	19.9	16.8	15.5	14.03

Tabela 7 – Rreshjet per kohzgjatje te ndryshme dhe siguri te ndryshme

Nga te dhenat e mesiperme kemi ndertuar kurbat intensitet-koezgjatje-frekuance te cilat jepen me poshte:

	Intensiteti (mm/h)			
	Periudha e rikthimit (vite)			
Kohezgjatja (ore)	**500**	**100**	**50**	**20**
24	5.4	4.5	4.2	3.8
12	8.3	6.9	6.4	5.8
6	12.7	10.7	9.9	9.0
2	25.3	21.3	19.7	17.8
1	39.0	32.8	30.4	27.5
0.5	60.2	50.6	46.8	42.4
0.33	78.1	65.6	60.7	54.9
0.25	92.8	78.0	72.2	65.3
0.1667	119.6	100.5	93.0	84.2

Tabela 8 – Intensiteti-Kohezgjatja-frekuenca



Figura 7 - Kurbat IKF

4.3 Rrjedhja ujore vjetore dhe maksimale e lumit Osum

Në rrjetin hidrografik të lumit Osum kane funksionuar tre vendmatje kryesore hidrometrike të instaluara në trungun e këtij lumit, si: vendmatja në aksin Leshnje, aksi Qafëzez, aksi Çorovode dhe Osumi ne aksin e Urës Vajgurore, te cilat karakterizohen nga seri relativisht te gjata vrojtimi.
Në këtë studim ne jemi të interesuar të japim informacion hidrologjik për lumin Osum ne luginen e Berat e cila ndodhet midis vendmatjeve Corovode dhe Ura Vajgurore.

Stacioni hidrometrik	F km^2	H masl	Q_{mes} m^3/s	q $l/s/km^2$
Çorovode	1091	1101	14.3	14.7
Ura Vajgurore	1928	30	29.7	15.4

Tabela 9 –Te dhenat kryesore te stacioneve hidrometrike

Vërehet se vlerat e prurjes fillojnë te rriten dhe të kalojnë prurjen mesatare shumëvjeçare ne muajt nëntor-dhjetor dhe vazhdojnë rreth këtyre vlerave deri ne muajin maj, pra gjate periudhës se dimrit. Kjo përkon me periudhën e shirave, rënia e te cilave bën qe te shtohet sasia e ujit në lume, pra reshjet ne forme shiu kontribuojnë direkt ne rrjedhje.

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Prurja mesatare m^3/s (Çorovoda)	21.3	22.3	22.7	22.8	19.5	8.48	4.22	2.86	3.57	6.72	14.0	23.3	14.3
Prurja mesatare m^3/s (Ura Vajdurore)	44.2	46.3	47.1	47.3	40.4	17.6	8.7	5.93	7.4	13.9	29.0	48.3	29.7

Tabela 10 – Shpërndarja brendavjetore



Figura 8 - Shpërndarja brendavjetore

Seritë e prurjeve maksimale te këtyre vendmatjeve janë relativisht të gjata dhe nuk lind nevoja e zgjatjes se tyre. Këto seri te prurjeve maksimale ju nënshtruan trajtimit statistikor, me ane të një programi kompjuterik të posaçëm dhe u përdoren shpërndarjet e përshtatshme për vlerat ekstreme. Duke përdorur edhe teste të ndryshme sipas rastit u vlerësuan shpërndarjet përkatëse me te mira. Këto rezultate paraqiten në tabelën e meposhtme

Probabiliteti (%)	1	2	5
Corovode	667	600	507
U. Vajgurore	1211	1148	1021

Tabela 11 – Prurjet maksimale sipas vendmatjeve Corovode dhe Ura Vajgurore

5 MBROJTJA NGA PERMBYTJET, ARGJINATURA

Siç u permend dhe me siper trupi i rruges eshte kryesisht ne mbushje dhe ajo sherben edhe si argjinature. Nga ana tjeter rikualifikimi i Unazes se Beratit perfshin edhe nderhyrjen ne rrugen ekzistuese qe ndodhet ne kuroren e argjinatures. Per keto arsye eshte e nevojshme analiza e efektit te ketyre nderhyrjeve ne perballimin e prurjeve maksimale.

Figura 9 – Planvendosja e argjinatures ekzistuese 1:25000



Figura 10 – Planvendosja e rruges sipas projektit



Figura 11 – Niveli i rruges perkundrejt nivelit ekzistues ne pjesen e argjinatures

Figura 12 - Shperndarja zonale e reshjeve ditore neper Shqiperi

5.1 Percaktimi i parametrave te plotes ne lumin Osum per analizen e argjinatures

5.1.1 Periudha e rikthimit

Pyetja e pare qe ngrihet ne kete rast eshte me cfare sigurie duhet te projektohet argjinatura e re. Menyrat me te mira per te vleresuar periudhen e rikthimit jane ato qe bazohen ne modelet e riskut per zonen specifike. Duke qene se nje vleresim i tille kaq i detajuar del jashte qellimit te projektit do te perdorim standartin e Gjermanise per periudhen e rikthimit te plotes per projektimin e argjinaturave. Per kete jemi bazuar ne buletinin "EUCOLD Working Group on Levees and Flood Defences July 2018", ku nder te tjera raportohet se standarti i Gjermanise per prurjet llogaritese te argjinaturave krijon sigurine e duhur ne varesi te zonave dhe specifikave te tyre duke ruajtur edhe baancen ekonomike te ndertimit.

Kategoria	**Demi i mundshem**	**Periudha e rikthimit**
Objekte te veçanta me pasoja te renda ne rast permbytje	I madh	Merret ne varesi te rastit specifik por zakonisht 500 vjet eshte e justifikueshme
Zona urbane	I madh	100 vjet
Zona industriale	I madh	100 vjet
Infrastrukture nderurbane, rruge, hekurudha, magazine etj	I madh	50 – 100 vjet
Ndertesa te vecuara, zona me banim te perkohshem	Mesatar	25 vjet
Infrastrukture nderurbane me zhvillim te ulet	Mesatar	25 vjet
Zona bujqesore	I ulet	5 vjet
Zona natyrore	I ulet	-

Tabela 12 – DWA-Udhezues 507-1 per argjinaturat dhe DIN 19712:2013,Tabla 2

Nga sa me siper mund te themi qe zona e cila do te mbrohet nga argjinatura eshte zone urbane dhe periudha e rikthimit eshte 100 vjet.

5.1.2 Prurja llogaritese

Per percaktimin e prurjes llogaritese do te perdorim metoden e reduktimit (ref: Hidrologjia Inxhinierike 2009 Prof.Dr Agim Selenica) sipas formules se meposhtme:

$$Q_{1\%}^{Berat} = Q_{1\%}^{Ura\,V} x \sqrt{\frac{F_{Berat}}{F_{Ura\,V}}} = 1211\, x \sqrt{\frac{1750}{1928}} = 1143\, \frac{m^3}{s}$$

$Q_{1\%}^{Berat}$ – *prurja maksimale ne lumin Osum me probabilitet 1% ne aksin e Beratit*

$Q_{1\%}^{Ura\,V}$ – *prurja maksimale ne lumin Osum me probabilitet 1% ne vendmatjen Ura Vajgurore*

F_{Berat} – *siperfaqja e pellgut ne aksin e Beratit*

F_{Berat} – *siperfaqja e pellgut ne aksin e Beratit*

5.1.3 Koha e bashkardhjes

Në këtë rast Metoda e Kirpich në të cilat mbizotëron rrjedhja në shtretër natyrore

$$t_c = 0.0195 \left(\frac{L^{0.77}}{S^{0.385}} \right)$$

t_c – *koha e përqëndrimit* (min)

L – *gjatësia e rrjedhës* (m)

S – *pjerrësia mesatare*

Në këtë rast koha e përqëndrimit është llogaritur si më poshtë:

$L = 105000\ m$

$S = 0.007$

$$t_c = 0.0195 \left(\frac{105000^{0.77}}{0.007^{0.385}} \right) = 974 \text{ min } (\approx 16.3\ h)$$

5.1.4 Hidrograma e plotes

Hidrograma sintetike e plotes është një hidrogama teorike që përshkruan një përmbytje që mund të ndodhë në kushte të caktuara për një prurje maksimale te caktuar. Ka pak metoda që lejojnë të llogaritet ecuria kohore e nje hidrograme sintetike.
Në këtë rast është përdorur metoda e Reitz-Kreps [Lambor, 1962] që përshkruan formën e hidrogrames sintetike nga dy ekuacione: njeri per pjesen rritese te hidrogrames ndersa tjetri per pjesen e uljes se prurjes.
Për pjesen rritese te hidrogrames, që është për kohën 0 ≤ t ≤ tk, ekuacioni merr formën:

$$Q(t) = Q_{p\%} \sin^2\left(\frac{\pi t}{2t_k}\right)$$

Per pjesen në rënie te hidrogrames se plotes, për kohën t> tk, përshkruhet nga ekuacioni:

$$Q(t) = Q_{p\%} e^{-\alpha(t-t_k)}$$

Ku:

Q – prurja ne kohen t $\left(\frac{m^3}{s}\right)$

$Q_{p\%}$ – prurja e pikut me probabilitet p% $\left(\frac{m^3}{s}\right)$

t_k – koha e perqendrimit (h)

α – koeficient me permasa $\left(\frac{1}{h}\right)$

Vlera e α mund te percaktohet:

$$\alpha = \frac{\ln 2}{(s-1)t_k}$$

where *s* is the flood hydrograph slenderness coefficient [-] defined as

$$s = \frac{t_{0.5Q_{max}}}{t_k}$$

Ku $t_{0.5Q_{max}}$ eshte koha [h] nga fillimi i hidrogrames deri ne kohen ku prurja behet sa gjysma e prurjes maksimale ne pjesen zbritese te hidrogrames Qmax (=Qp%). Ne pergjithesi merret

$$t_{0.5Q_{max}} = 1.75t_k \rightarrow \alpha = 0.4$$



Figura 13 – Hidrograma e plotes me probabilitet p = 1% lumi Osum,Berat

5.2 Modelimi hidraulik i kalimit te plotes Berat

5.2.1 Modeli

Modelimi i permbytjes eshte bere ne programin HEC-RAS. Ky program eshte i projektuar qe te kryej llogaritjet hidraulike nje-dimensionale ose dy-dimensionale ten je rrjeti hidrologjik natyror ose kanale artificiale duke perfshire edhe rrjedhen jashte brigjeve te lumit ose ne zonat e permbytjeve. Gjithashtu ky program mund te kryeje edhe llogaritjet e lumenjve te shoqeruar me argjinatura, tombino, ura e shume struktura te tjera lumore.

- Gjeometria

Dritarja e informacionit gjeometrik eshte pamja kryesore e programit HEC-RAS. Ketu vendosen te gjitha strukturat e modelit si lumi, brigjet, tombinot, urat argjinaturat, zonat e permbytjes etj.